

Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Së pari, ministri i Drejtësisë duhet të ishte këtu, sepse unë kam disa çështje për të ngritur dhe dëshiroj që personi që prezanton këtë projektligj të jetë prezent. Nuk ka asgjë më të rëndësishme sesa diskutimi i një projektligji, edhe për ministrin e Drejtësisë, për më tepër, kur disa nga vërejtjet për sa i përket të drejtës për informim, i kam drejtpërsëdrejti për ministrin, i cili na prezantoi sot një projektligj, që sikurse pretendoi ai dhe të gjithë kolegët e mazhorancës, është një projektligj në funksion të së drejtës së informimit të qytetarëve. Ministri nuk është. Në asnjë rast nuk është. Përkundrazi, ky projektligj krijon hallka shtesë, krijon zyra censure, zyra kontrolli të informacionit, sepse, me sa duket, edhe ju ka shpëtuar ndonjë informacion pa e kontrolluar, dhe tani krijoni zyra që të censurojnë dhe të kontrollojnë çdo lloj informacioni. Ministri tha që i vinte shumë keq për disa punonjës, për shembull, të bashkisë, sikurse i përmendi ai, që detyroheshin të paguanin edhe trefishin e pagës së tyre. Pse? Sepse nuk kryejnë një detyrim kushtetues. E drejta për informim është e drejtë kushtetuese dhe çdo punonjës, kudo që punon, nëse i ngarkohet një detyrë duhet ta kryejë. Nëse ai nuk e kryen këtë detyrë, atëherë merret masë administrative për të, ashtu sikurse e ka ligji. Dakord, për një moment, e pranojmë se qenka shumë e lartë gjoba sa trefishi i rrogës, që marrka ky punonjës i iks bashkie. Pyetja që kam unë është: a ju vjen keq juve për mjekët e familjes? A i vjen keq ministrit të Drejtësisë për ata mjekë që gjobiten çdo muaj gjysmën e rrogës apo më shumë se gjysmën e rrogës, nëse nuk bëjnë numrin që u është caktuar nga Vilma Nushi për analizat e check up-it, që nuk është detyrim ligjor? Pra, ju thoni: “T’ia ulim gjobën këtij personi, që nuk kryen një detyrim ligjor, ndërsa mjeku duhet ta paguajë gjobën, gjysmën e pagës”. Pse? Sepse ia kërkon Vilma Nushi. Pse? Sepse e gjithë administrata duhet të jetë në këmbë për Vilma Nushin. Pse këto dy standarde?

Madje, në njërën prej shkresave të fundit, që unë i kam dërguar Ministrisë së Shëndetësisë, për të cilën ende sot pas një muaji nuk kam marrë përgjigje, kam kërkuar pikërisht numrin e mjekëve, të cilët janë gjobitur nga momenti kur ka hyrë në fuqi ligji, që u vë gjoba nëse nuk i bëjnë Vilma Nushit numrin e caktuar të check up-ve. Nuk kam marrë përgjigje për këtë shkresë. Kush mban përgjegjësi për këtë? Kam kërkuar edhe nivelin e gjobës për çdo mjek, por nuk kam marrë përgjigje. Kush mban përgjegjësi për këtë, zoti Ministër? Edhe ju nuk më keni kthyer përgjigje. Kam dërguar disa shkresa, por nuk kam marrë përgjigje, ku kam kërkuar informacion për numrin e përgjithshëm në vijueshmëri, disa herë në vit për check up-in, disa herë në vit për sterilizimin, disa herë në vit për laboratorët apo informacione të tjera nga ministri të ndryshme. I kam dërguar zëvendëskryeminstres dhe ministres së Transportit, zonjës Balluku, por ministrja, zëvendëskryeministrja, as denjon të kthejë përgjigje! I kam dërguar disa kërkesa Erion Veliajt, por zero përgjigje. Pra, ku është e drejta për informim, kur ne, si deputetë, nuk marrim përgjigje, kur ministrat nuk denjojnë të kthejnë përgjigje? Pse? Sepse peshku qelbet nga koka. Pse? Sepse ne kemi një Kryeministër që sfidon Parlamentin, që refuzon të jetë në këtë Parlament, që refuzon të përgjigjet ndaj Parlamentit! I kam kërkuar edhe Kryeministrit informacion para një muaji për konsulencat e huaja për 13 kontrata me shuma marramendëse, vetëm në gjashtë muajt e parë të këtij viti. Ka kthyer përgjigje për të mos kthyer përgjigje. Ka dhënë vetëm tre emra, jo 13, dhe thotë se “ato kontratat për ata persona që marrin fondet nga taksat tona, pra fondet publike, qenkan të dhëna personale dhe nuk i vihen në dispozicion një deputeti”. Pra, si t’ia bëjmë, zoti Ministër, kur asnjë ministër nuk përgjigjet? E kam ngritur këtë shqetësim duke ndjekur edhe procedurën ligjore. Vetëm në vitin 2021 kam dërguar, e kam mbajtur shënim, 26 kërkesa. Kam më shumë se kaq, në fakt, por kaq kam në listën këtu. (Deputetja Vokshi tregon disa pamje.)

Për të gjitha këto që shikoni me të verdhë, ja, nuk ka përgjigje, nuk ka përgjigje, nuk ka përgjigje. Nuk japin përgjigje! I jam adresuar Komisionerit, që na e lëvduat pa fund të gjithë ju, se kishte bërë një punë shumë të mirë. Po çfarë pune të mirë ka bërë, kur ka mbrojtur mosdhënien e informacionit, kur ka mbrojtur mosbërjen transparencë, kur ka mbrojtur një shkelje të Kushtetutës?! I jam adresuar në mënyrë zyrtare Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe i kam thënë që zëvendëskryeministrja nuk më ka dhënë informacion për Unazën e Tiranës, që ministrja e Shëndetësisë nuk më ka dhënë këtë informacion (ndaj shkresës me këtë numër protokolli, me këtë datë) për check up-in, për analizat. A e dini se çfarë ka thënë Komisioneri? Po, ka kthyer përgjigje Komisioneri brenda afatit ligjor dhe ka thënë: “Po, statusi i deputetit të jep Kuvendi të drejtën që ta marrësh informacionin që ke kërkuar, por shko te Kryeministri, se unë nuk kam ç’të të bëj!”. Atëherë, si ta gjej unë të drejtën time kushtetuese, në funksion të pozicionit si deputete, për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe jo të pushtetarëve? Si ta marr unë këtë informacion? Ndërkohë, ju vini e lavdëroni Komisionerin për të Drejtën e Informimit, kur unë nuk marr informacion? Po ai qytetari...? Meqenëse më këshilloi edhe Komisioneri, që t’i drejtohem si qytetare kësaj here, sepse “si deputete - më tha - unë ty nuk të mbroj dot”, i jam drejtuar AKEP-it, si qytetare, për kompaninë “One” lidhur me masat që ka ndërmarrë AKEP-i ndaj të gjithë abuzimit që kompania “One” bënte me abonentët. I kam kërkuar të di thjesht se çfarë është vendosur në mbledhje; zero përgjigje. Pra, edhe si deputete nuk mora përgjigje, edhe si qytetare asnjë përgjigje. Atëherë, për çfarë po diskutojmë ne sot këtu? Për çfarë po e lavdëroni Komisionerin, se unë nuk di si ta gjej këtë? Futeni në një rreth vicioz. Jo më larg se para një jave, kam kërkuar, përsëri duke respektuar Rregulloren, katër dëgjesa në Komisionin e Shëndetësisë. Pra, duke mos marrë asnjë informacion nga ministrat në rrugë shkresore, ja ku i keni një pjesë prej tyre (mund t’ia jap kujt është i interesuar, këto janë vetëm të dy javëve të fundit, për të cilat nuk kam marrë asnjë përgjigje), kam kërkuar në komision katër dëgjesa: me ministren Ogerta Manastirliu për kushtet e Onkologjikut pas raportit të KLSH-së, në fakt, për kushtet skandaloze, ku vetëm në 2 vjet kanë rrezikuar jetën e 600 pacientëve, dhe e rrëzuan me votë. Kërkova dëgjese me Ogerta Manastirliun për sterilizimin, e rrëzuan me votë ata që kanë bërë betimin e Hipokratit! Nuk menduan për interesin e pacientëve, as të votuesve të tyre, por menduan për interesin e Ramës, të Ogertës dhe të Beqajt! Katër kërkesa, të katërta i rrëzuan! Atëherë, për çfarë po flasim sot? Edhe ligji që na keni sjellë, jo vetëm nuk e ndihmon të drejtën kushtetuese për informim, por përkundrazi, po censuroni edhe më shumë të drejtat.

Faleminderit!